| III | Pozicioni me 31 Dhjetor 2008 | 134,040,594 | 145,835,057 | | 164,656 | 46,812,775 | -173,446,011 | 47,474,404 | 37% | 47,474,404 |

# SHENIME SHPJEGUESE

## Per Pasqyrat Financiare te Shoqerise Mika Korca Sh.A

## Periudha 01/01/2008-31/12/2008

| | |
|---|---|
| **EMRI I SHOQERISE** | **MIKA KORCA SH.A** |
| **DATA E KRIJIMIT** | **1993** |
| **STATUSI I SHOQERISE** | **Shoqeri Anonime.** |
| **SELIA** | **KORCE** |
| **ADMINISTRATORI** | **GEORGES SOUGKARIS** |
| **VEPRIMTARIA QE KRYHEN** | **Grumbullim, perpunim, Fermentim, Eksport Duhani.** |
| **N.I.P.T** | **J64103104K** |
| **NR I TE PUNESUARVE** | **185** |
| **ADRESA** | **Ish (Ndj Grumbullim Perpunim Duhanit) Unaza e Qytetit KORCE.** |
| **TEL/FAX** | **0822431-45** |

## I. INFORMACION I PERGJITHSHEM DHE POLITIKAT KONTABILE.

Pasqytat financiare te vitit ushtrimor dt:01/01/2008-31/12/2008 jane ndertuar ne menyre individuale ne baze te Standarteve Kombetare te Kontabilitetit numur 2 dhe ligjit Nr:9228 Dt:29/02/2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", standart I cili ndryshon nga plani kontabel I pergjithshem ne permbajtje, forme dhe ne trajtime dhe zbatohen per here te pare ne sistemin Ekonomiko Financiar te vendit tone, sipas Politikave te reja Kontabile.

Kerkesat e S.K.K parashikojne qe politikat e reja kontabile te zbatohen ne menyre rigoroze prospektive per periudhat e ardhshme dhe pa ndryshuar pasqyrat financiare krahasuese te vitit 2007.

Aktiviteti Eko-Financiar I vitit 2007 eshte pergatitur simbas kerkesave te Planit Kontabel te Pergjithshem (PKP) pa politikat e reja kontabel dhe ne Pasqyrat Financiare (P.F) te vitit 2008 eshte bere vetem riklasifikimi I zerave ne perputhje me kerkesat e pasqyrave te Aktiveve, Pasivet e Kapitalet, Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve, Pasqyra e Fluksit Monetar, Pasqyra e Ndryshimeve te Kapitalit si percaktohen dhe ne SKK2.

Duhet te theksojme se treguesit ekonomiko-financiare te vitit 2007 te riklasifikuara simbas kerkesave te SKK2, jane te pakrahasueshme me treguesit Ekonomiko- Financiar te vitit 2008, mbasi per vitin 2007 nuk jane zbatuar politikat e reja per kontabilitetin simbas kerkesave te SKK2.

## A. Riklasifikimi I rubrikave te Bilancit 2007 simbas pasqyrave te reja financiare te vitit 2008 simbas SKK2.

Ne pasqyrat financiare te vitit 2007, diferencat e kembimit te lindura nga ndryshimi I kursit valutor (kursi valutor I faturimit per shitje dhe atij te likujdimit) per llogarite "Kliente per shitje, sherbime" dhe "Furnitore per blerje dhe sherbime" simbas rastit vendoseshin ne llogarite e Aktivit ose Pasivit te Bilancit sipas PKP ne zerin "Humbje/Fitim nga shkembimet valutore" te cilat jepnin efektin e tyre financiar ne rezultatin ushtrimor, ndersa rivleresimi I valutes si gjendje ne dt:31/12/2007 me kursin valutor te Bankes se Shqiperise (USD, EURO) per llogarite e siperpermendura (411,404) diferencat Aktive dhe Pasive jane paraqitura ne llogarite Aktive dhe Pasive te Bilancit te vitit 2007 ne zerat: Diferenca Aktive e Pasive perkatesisht tek llogaria 476 per 85.350.926 Lek dhe llogaria 477 per 118.441.137 Lek (diference pasive per 33.090.211 Lek.) Kjo diference konvertimi e rivleresueshme nuk merret parasysh ne rezultatin financiar te ketij viti, sipas regullave egzistuese te PKP, mbasi ne celjet e reja te llogarive ne vitin pasardhes keto diferenca Aktive dhe Pasive ju riktheheshin llogarive Kliente, Furnitore apo dhe Kreditore te Tjere per furnizimet apo sherbimet ne valute te huaj.

Me sistemin e ri te S.K.K.2 kerkohet pasqyrimi I ketyre diferencave ne efektin financiar te vitit ushtrimor, - pra te pasqyrohet efekti I diferencave ne rezultatin Humbje apo Fitime te vitit ushtrimor 2008.

Konkretisht zeri "Diferenca konvertimi Aktive e Pasive" ne Llogarite Vjetore (Gjendjet Financiare) te vitit 2007 sipas PKP paraqiten ne kete menyre:

| Pozicioni ne Bilanc | Emertimi | Aktivi | Pasivi |
|---|---|---|---|
| Aktivi C II a | Klienti | 611.932.990 | = |
| Pasivi B I d | Furnitore | = | 380.251.251 |
| Pasivi B I f | Kreditore | = | 40.450.320 |
| | | 611.932.990 | 420.701.571 |
| Diference Konvertimi | | 85.350.926 | 118.441.137 |

ndersa ne Pasqyrat Financiare simbas SKK2 te vitit 2008 I riklasifikuar treguesit e vitit 2007 te ketyre diferencave konvertuese Aktive dhe Pasive paraqiten ne Pasqyren Financiare tek: Pasivet e Kapitalit ne kapitullin I.Nr: rendor 6 te emertuar nga vete Subjekti yne te quajtur: "Te Ardhura te mara ose rregjistrime avance" (diferenca konvertimi Pasive) per diferencen midis Aktivit e Pasivit per 33.090.211 Lek, (Efekt kuadrature te Bilancit te vitit 2007), ndersa ne Pasqyren e te Ardhurave e Shpenzimeve ne elementin Nr:13.3 nuk eshte paraqitur per efekt kuadrature.

## B. Politikat Kontabel

Per vleresimin e te gjithe elementeve te Pasqyrave Financiare per vitin 2008 jemi mbeshtetur ne Politikat Kontabel te percaktuar ne Standartin Kombetar te Kontabilitetit dhe Ligjit te Kontabilitetit Nr:9228 Dt:29/04/2004.

Kryesisht Pasqyrat Financiare jane pergatitur ne baze te parimit te te drejtave dhe detyrimeve, perputhshmeria e te Ardhurave me Shpenzimet e kryera dhe vijimesia e veprimtarise se njesise ekonomike.

Monedha me te cilen shprehen te gjithe treguesit financiare eshte leku Shqipetar.

*KONKRETISHT:*

## AKTIVET

- 1. **Aktivet Monetare** jane vleresuar me vleren e drejte dhe paraqiten per vleften 77.305.317 Lek. Transaksionet e kryera gjate vitit ushtrimor, ne monedhe te huaj, jane vleresuar ne Lek me kursin korent te bankes perkatese ndersa llogarite bankare qe paraqiten si gjendje ne daten 31/12/2008, ne monedhe te huaj, jane vleresuar ne Lek me kursin e monedhes parkatese te publikuar nga Banka e Shqiperise me date 31/12/2008, I cili per kete vit rezultoi me +486 Lek qe kalui ne rezultat te Subjektit.

- 2. **Aktivet e tjera Financiare Afatshkurtra**. jane vleresuar me kosto simbas SKK3 dhe paraqitet ne Aktivet e Bilancit ne vlere 498.168.308Lek, ne perberje te ketij elementi vlen te permendim vetem klientin e vetem qe kemi ne si Subjekt, "Leaff Tobacco & Agricultural" A. Michailides qe paraqitet ne zerin "Klienta per Mallra, Produkte Sherbime" per vleften 404.315.627 Lek.

Veprimet Financiare per eksportin e duhanit (Greqi) jane vleresuar ne monedhe te huaj dhe ne lek (Euro x Kursi valuator I Doganes te dites se eksportit), ndersa likujdimet e faturave te duhanit me kursin korent te dites simbas bankave te ndryshme (Euro x Kursi valutor I dites).

Per te gjitha gjendjet e rezultuara te valutes te dates 31/12/2008 per Kliente dhe Furnitoret eshte bere vleresimi ne Lek me kursin e dates 31/12/2008 te shpallur nga Banka e Shqiperise. Diferencat Aktive e Pasive nga ky konvertim (rivleresim) kane rezultuar Pasive per vleften 46.399.876 Lek (Dif: Aktive 61.798.223)-(Dif: Pasive 108.198.099).

Treguesit financiare te tjere si: paradhenie per sherbime (Debitore ,Kreditore te tjere) paraqit pjeserisht paradhenie sherbimi te pakthyer ose te pa likuiduar nga specjalistet tane si dhe vleften e Plehut Kimik (per 1.748.000 Lek) te pa likuiduar nga fermeret; ndersa Tatim Fitimi dhe TVSH

paraqiten treguesa te pashlyer ndaj nesh nga Dega e Tatimeve Korce perkatesisht: (12.868.488 Lek dhe 79.225.130 Lek) prej disa vitesh.

## - 3. Inventaret

Inventaret e paraqitur ne vleften 140.438.596 Lek perfaqesohen kryesisht nga lenda e pare – blerje duhani per vleften 139.701.226 Lek dhe pjesa tjeter mbetet per inventarin e imet.

Si lenda e pare dhe inventari I imet jane vleresuar me koston e blerjes dhe menyra e evidentimit kontabel eshte sipas metodes se inventarit te perhershem per materialet e para dhe per produktin e gatshem.

## -4. Parapagime dhe Shpenzime te Shtyra

Po gjithashtu I njejti vleresim dhe evidentim kontabel eshte bere edhe per Shpenzimet e Periudhave te Ardhshme qe paraqitet per vleren 12.911.652 Lek.

## - 5. Aktivet Afatgjata Materiale

Ky element paraqit te gjitha Aktivet Afatgjata Materiale ne vleften neto prej 112.615.729Lek te dates 31/12/2008 (Mbetje) dhe Amortizimin e llogaritur per A.A.M (SKK5;38) eshte bere mbi bazen e normave te amortizimit te Sistemit Fiskal ne fuqi:

| | | |
|---|---|---|
| - Ndertesa | 5% | mbi vleften fillestare+hyrje dhe dalje. |
| - Mak. e Pajisje te trupezuara | 5% | " " " |
| - Mak e Pajisje te patrupezuara | 20% | me vleften e mbetur. |
| - Mjete Transporti | 20% | " " |
| - Mobilje e orendi | 20% | " " |
| - Pajisje Informatike | 25% | " " |

Bejme te ditur se amortizimi I Mak. Pajisje te Trupezuara dhe te Pa Trupezuara per vitin 2008 eshte llogaritur vetem per shtate muaj pune sezonale, ndersa per pese muajt pa pune ne (konservim) nuk eshte llogaritur amortizim simbas V.K.Mbikqyres date 10/01/2008, per arsyen e grumbullimit te pakte si sasi te duhanit gjate periudhes Nentor - Dhjetor 2007 per llogari te vitit 2008.

# PASIVET

## -6. Huate e Parapagimet.

Te paraqitura ne Pasqyren Financiare me emertesen "Pasivet e Kapitalet", Huate e Parapagimet perbehen nga disa nen zera si: Te pagueshme ndaj furnitureve, Punonjesve, Detyrime Tatimore per TAP [in] Tatim ne Burim dhe Debitore e Kreditore te Tjere qe ne total Paraqiten ne vleften 792.924.044 Lek.

Te pagueshme ndaj Furnitoreve vendas jane vleresuar me kosto (cmimin e blerjes), ndersa furnizimet nga jashte (Greqia) jane shprehur ne monedhe te huaj dhe lek. Cdo here monedha e huaj eshte konvertuar ne lek sipas kursit doganor aktual (ditore) dhe per gjendjen e valutes te rezultuar me daten 31/12/2008 ashte kryer rivleresimi ne Lek me vleren e valutes te shpallur nga Banka e Shqiperise.

Edhe ky tregues eshte paraqitur ne kete ze vetem per vleften reale te valutes se dates 31/12/2008 (konkretisht: 710.931.696 Lek nga te cilet; furniture vendas jane 78.325.040 Lek te perfaqesuar ne kosto blerje dhe furnitori I vetem I jashtem Leaff Tobacco A. Michailides S.A ne valute dhe lek per vleften 397.592.188 Lek si dhe furnitori vendas baze per makineri dhe pajisje ne lek qe eshte Mika Berati Sh.A per shumen 235.014.468 Lek).

Njekohesisht edhe zeri Debitore e Kreditore te Tjere paraqit pjeserisht vetem nje Kreditor ne valute dhe ne lek (P. Moskov) ne vleften 42.900.080 Lek per furnizime te ndryshme qe ne momentet e krijimit te Subjektit tone; ndersa pjesa tjeter e ketij zeri (Debitore e Kreditore te Tjere) paraqiten kreditore te ndryshem ( detyrime ) te Mika Korces ndaj te treteve si: Energji Elektrike, AlbTelekom etj, per vleften 12.631.583 Lek, kreditori tjeter Ballkan Trans 10.774.020 Lek. Dega e Tatim Taksave Korce per 13.318.053 Lek etj.

Krahas kesaj Detyrime te Pagueshme paraqiten ndaj punonjesve per 1.439.870 Lek Sig,Shoq.Shendetsore per 555.677 Lek per TAP "" 157.851 Lek etj.

## -7. <u>Te Ardhura te Marra ose Regjistrime Avance (Diferenca Konvertimi Pasive)</u>

Ne kete Pasqyre Financiare (Pasivet e Kapitalet) eshte percaktuar emertimi I llogarise dhe vendosur ne kete pasqyre Nr rendor 6 me emertimin Te Ardhura te Marra ose Regjistrime Avance (Diferenca Konvertimi Pasive) vlefta prej 33.090.211 Lek, nga vete subjekti per efekt kuadrature Bilanci per vitin 2007.

## -8. <u>Provizione Afatgjata</u>

Bejme me dijeni se ky Element Financiar eshte krijuar prej disa vjetesh si rezultat I shperndarjes se fitimit me qellime prespektive per mbulime te shpenzimeve te pa parashikuara per Subjektin ne periudha te ardhshme dhe qe efektivisht me mbylljen e ketij Bilanci, miratimin e tij mendohet te sistemohet dhe te kaluje ne Kapitullin e Rezervave Ligjore ose ne Fitimet e Pa Shperndara.

## -9. Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve.

Pasqyra Financiare e te Ardhurave dhe Shpenzimeve paraqet elementet kryesore te te ardhurave nga aktiviteti kryesor dhe nga te tjera veprimtari si dhe shpenzimet materjale, pune e gjalle dhe financiare.

Konkretisht:

-Shitjet neto per vleften 205.714.510 Lek perbehen vetem nga shitja e Produktit te Gatshem, Duhane ne Greqi.

-Ndryshimi ne Inventarin e Prodhimit te Gatshem dhe Prodhimi ne Proces me rezultat negative (7.606 Lek) ka ardhur si rezultat I ndryshimit te gjendjes vetem te Prodhimit te gatshem ne vitin 2007 ne magazine qe eshte marre si e Ardhur per vitin 2007 dhe me efekt negative per vitin 2008 po me te njejten vlere.

## -10. Te Ardhura e Shpenzime Financiare

Te Ardhura e Shpenzime Financiare per vleften 48.565.051 Lek perbehet nga te ardhurat nga Interesat per 83.035 lek, Fitimi nga kurset e kembimit per 412.899 Lek dhe nga vleresimi I valutes me kursin e dates 31/12/2008 per shumen 46.399.876 Lek (diferenca vleresimi aktive per 61.798.223 Lek dhe diferenca vleresimi pasive per 108.198.099 Lek); dhe nga te Ardhura te tjera Financiare nga Shitjet e Aktiveve te Qendrueshme per 1.098.976 Lek , te tjera Financiare per 580.265 Lek. Pra ne Total e Ardhura gjate perjudhes 01/01/2008 - 31/12/2008 perbehet nga shuma 246.673.061 Lek.

Ne vijim te analizes se elementeve te Shpenzimeve njohim Blerje Lende te Pare dhe Materiale vleften 209.747.559 Lek Koston e punes, per 39.063.022 Lek Amortizimin e mjeteve kryesore per 12.532.636 Lek dhe Shpenzime te tjera si Energji Elektrike PTT Transport Duhani sherbime dhe nen trajtime nga te tretet, Shpenzime Kancelerie e Roje objekti etj, Komisione Bankare sherbimi e transferimi etj per vleften 44.449.736 Lek.

Ne total shpenzimet per periudhen ushtrimore per vitin 2008 rezultojne 305.792.953 Lek. Diferenca midis te Ardhurave dhe Shpenzimeve rezulton nje humbje prej 59.119.892 Lek.

## -11. Fluksi Monetar

Fluksi Monetar nga veprimtaria e shfrytezimit perbehet si e ardhur kryesore vetem nga klienti Leaff Tabacco dhe Agricultural A. Michailidesi klienti me kryesor per likuidimin e faturave te duhanit gjate ketij viti per vleften 436.884.577 Lek. Ndersa Mjete Monetare te paguara ndaj furnitoreve dhe punonjesve e cila perbehet prej shumes 359.006.800 Lek , pjesen me te madhe te

likuiditeteve e ze likuidimi I duhaneve te blera nga fermeret per shumen lek 261.824.173, pagat e punonjesve 29.552.483 Lek, Sigurimet Shoqerore 11.343.790 Lek, Blerje materiale te tjera per prodhimin 16.416.112 Lek dhe pjesa tjeter per shpenzime te tjera prodhimi si transport, materiale zyre, reklame, mirembajtje etj.

### Interesat

Gjate vitit 2008 subjekti ka arketuar nga shkembimet valutore dhe interesat shumen Lek 495.448 dhe si rezultat I shkembimeve valutore gjate arketimit te faturave te klienteve ne monedhe te huaj, subjekti ka paguar 9.478.643 Lek, shume e cila ka ndikuar ne rritjen e shpenzimeve per kete vit.

**Administratori**

**Georges Sougkaris**

MIA KORCA SA
KORCA
ALBANIA

**STATUTI**
**I**
**SHOQËRISË ANONIME PA OFERTE PUBLIKE.**
**"MIKA KORCA" SH.A.**

**NENI 1**

**EMERTIMI DHE STATUSI LIGJOR**

Shoqeria **"Mika Korca" SH.A.** (me poshte referuar si "Shoqeria"), eshte nje shoqeri anonime pa oferte publike e krijuar ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Shoqerite Tregtare" dhe ligjit nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".

**NENI 2**

**Selia**

Selia zyrtare e shoqerise ndodhet ne adresen: **Unaza e Re, Korce, Shqiperi**. Per te ushtruar kete aktivitet, shoqeria mund te hape dege dhe zyra perfaqesimi kudo brenda dhe jashte Republikes se Shqiperise.

**NENI 3**

**KOHEZGJATJA**

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise eshte pa afat dhe fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit

**NENI 4**

**OBJEKTI**

- Shoqeria ka objekt te veprimtarise se saj grumbullimin, perpunimin dhe eksportin e duhaneve.
- Shfrytezimin dhe rinovimin e aseteve ekzistuese si dhe ndertimin e aseteve te reja depozituese e perpunuese te duhaneve.
- Zbatimin e teknologjive te reja per perpunimin dhe fermentimin e duhanit.
- Dhenien e ndihmes shkencore-agronomike, me teknologji ne fushen e kultivimit te duhanit, fermereve private me qellimin qe keta te fundit te rrisin cilesine dhe sasine e tij.
- Si dhe cdo aktivitet qe lidhet me kete objekt dhe qe konsiderohet si i nevojshem ose fitimprures nga Shoqeria.

## NENI 5

## AKSIONERET DHE KAPITALI

Aksioneret themelues te kesaj kompanie si rezultat I perthithjes se Shoqerise "Mika Berat" nga Shoqeria "Mika Korca" jane:

1. **"LEAF TOBACCO A. MICHAILIDES" SA**, zoterues i 62.02% te aksioneve te kapitalit te shoqerise;
2. **Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes**, zoteruese e 37.98% te aksioneve te kapitalit te shoqerise

(ketu te quajtur bashkarisht si **"aksioneret"**).

**Kontributet ne kapitalin themeltar te Shoqerise jane:**

1. **"LEAF TOBACCO A. MI CHAILIDES" SA**, kontribon ne Shoqeri me 1.778.510 (njemilion e shtateqind e shtatedhjete e tetemije e peseqind e dhjete) USD, duke zoteruar 17.786 (shtatembedhjetemije e shtateqind e tetedhjete e gjashte) aksione me vlere 100 (njeqind) USD seicili.

2. **Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes,** kontribon ne Shoqeri me 1.089.412 (njemilion e tetedhjete nentemije e katerqind e dymbedhjete) USD, duke zoteruar 10.894 (dhjetemije e teteqind e nentedhjete e kater) aksione me vlere 100 (njeqind) USD secili, perfshire ketu edhe 13.5% te kaluar ne dobi te pales shqiptare nga kapitali i ortakut "LEAF TOBACCO A. MICHAILIDES" SA.

Kapitali i nenshkruar per Shoqerine eshte 309.316.568 ALL (treqind e nentemillion e treqind e gjashtembdhjetemije e peseqind e gjashtedhjete e tete) Lekë dhe numri i autorizuar i aksioneve mbi te cilin kapitali do te jete i ndare eshte : 309.316 (treqind e nentemije e treqind e gjashtembedhjete) aksione te cilat do te kene nje vlere nominale prej 1000 (njemije) Leke per aksion.

## NENI 6

Shoqeria tregtare deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe permban ky Statut si dhe te legjislacionit Shqiptar ne fuqi. Ajo konsiderohet e krijuar ne daten e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

## NENI 7

Emertimi i shoqerise tregtare, kapitali themeltar, emrat e perfaqesuesve te shoqerise duhet te jene te permendura ne te gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqeri dhe qe ju drejtohen te treteve. Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme dhe me permbajtjen perreth saj.

## NENI 8

Shoqeria vepron nen regjimin e prones private dhe merr persiper vete te drejtat dhe detyrimet kontraktore dhe jashtekontraktore.

## NENI 9

## STRUKTURA ORGANIZATIVE E SHOQERISE

Organet drejtuese te komanise jane:

1. Asambleja e Pergjithshme e Aksionerve
2. Keshilli Mbikqyres
3. Administratori

## NENI 10

## ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E AKSIONEREVE

- Organi kryesor vendim-marres i Shoqerise eshte Asambleja e Pergjithshme e Aksionereve (me poshte referuar si **"Asambleja e Pergjithshme"**), e cila perbehet prej gjithe aksionereve te Shoqerise. Kompetencat e Asamblese perfshijne te gjitha kompetencat qe i jep asaj Ligji Nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregtare".

Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë :

1. Përcaktimi i politikave tregtare;
2. Shtesa dhe ndryshime në statut;

3. Krijimi i akteve normative dhe shtesat e ndryshimet në to;
4. Zgjedhja dhe shkarkimi i administratoreve dhe anetareve te keshillit mbikeqyres;
5. Zgjedhja dhe shkarkimi i likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të pavarur;
6. Vendosja e shpërblimeve për personat e përmendur në pikat 4 dhe 5;
7. Monitorimi dhe mbikëqyrja e vënies në zbatim të politikave tregtare nga administratoret përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të punës;
8. Miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve të punës;
9. Shpërndarja e fitimeve vjetore;
10. Ndarja e përqindjeve në pronësi në pjesë dhe tërheqja e përqindjeve në pronësi;
11. Përfaqësimi i shoqërisë tregtare në gjykatë dhe në procese të tjera kundër administratoreve;
12. Ristrukturimi dhe shpërbërja e shoqërisë tregtare;
13. Miratimi i rregullores së brendshme;

Asambleja e përgjithshme merr vendim në lidhje me pikat 7 dhe 8 pas marrjes së dokumenteve përkatës, bashke me raportin e administratorit, ose te keshillit mbikeqyres dhe raportin e auditorit.

**NENI 11**

**MBLEDHJET E ASAMBLESE**

Asambleja e pergjithshme mblidhet ne nje mbledhje vjetore me pranine e te gjithe aksionereve ne seline zyrtare ne Korce, Shqiperi, ose ne vend tjeter e vendosur mbi vendimin unanim te aksionerve, te pakten nje here ne vit. Mbledhja mund te thirret nga administratoret, antaret e keshillit mbikqyres dhe aksionereve qe perfaqesojne 5% te kapitalit sipas formes se percaktuar nga ligji.

Asambleja e pergjithshme duhet thirrur brenda 3 muajsh kur humbjet arrijne deri ne 50% te kapitalit fillestar dhe kur keto humbje jane regjistruara ne bilancin vjetor ose ne raportet financiare te ndermjetme.

Asambleja e Pergjithshme duhet thirruar kur shoqeria propozon te shese apo te bleje asete te cilat kane nje vlere me te madhe se 5% nga vlera e pergjithshme e aseteve te shoqerise.

## NENI 12
## RREGULLAT PER THIRRJEN E ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

Njoftimi per mbledhjen e asamblese ne te cilen permenden, pikat e rendit te dites, koha dhe vendi ku do te mbahet mbledhja, duhet te kryhet nepermjet nje njoftimi te shkruar, apo nepermjet postes elektronike (email) ne adresen e cdo aksioneri me te drejte vote, jo me pak se 21 dite perpara dites se mbledhjes.

Njoftimi duhet te permbaje:

a) Emrin e shoqerise, seline, oren, daten e mbledhjes.
b) Nje shpjegim te detajuar te procedurave qe do te ndiqen nga aksioneret ne menyre qe te marrin pjese ne te.
c) Nje informacion lidhur me te gjitha format me ane te te cilave do te plotesohen dhe do te hyjne ne fuqi Projekt-vendimet.
d) Lajmerimi per thirrjen e asamblese mund te publikohet edhe ne faqen zyrtare te internetit te Shoqerise me te gjitha detajet e lartpermendura.

Rendi i dites duhet te perfshije vendimet e propozuara, dhe ne rastet e ndryshimeve te rendesishme ne statut, permbajtjen e sakte te ndryshimeve.

Kur Asambleja nuk thirret ne formen e lartpermendur, mund te merren vendime te vlefshme vetem ne rast pjesmarrjeje te te gjithe aksionereve te Shoqerise te cilet shprehin deshiren e tyre per te mare vendime pavaresisht parregullsise se konstatuar ne thirrjen e asamblese.

## NENI 13

## KUORUMI DHE VENDIM MARRJA NE MBLEDHJE

Per ceshtjet qe vendoset me shumice te zakonshme asamblea e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese jane te pranishem ose te perfaqesuar aksioneret qe zoterojne me shume se 30% te aksioneve me te drejte vote.

Per ceshtje si ndryshim statuti, zmadhim ose zvogelin kapitali te rregjistruar, shperndarja e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise, asambeja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese aksioneret qe zoterojne me shume se gjysma e numrit te aksioneve me te drejte vote ose perfaqesuesit e tyre, marrin pjese ne votime personalisht ose votojne me shkrese apo mjete elektronike

- Per vendime te cilat kerkojne nje shumice te cilesuar, vendimi mund te jete I vlefshem vetem kur merret nga aksioneret e pranishem (ose perfaqesuesit e tyre) qe zoterojne ¾ e aksioneve me te drejte vote.

Ne rastet kur kuorumi nuk eshte vendosur, mbledhja mund te shtyhet ne nje date jo me vone, se 30 dite nga data fillestare e mbledhjes.

- Pjesemarrja mund te jete nepermjet pranise reale, formes shkresore, apo me ane te mjeteve te telekomunikimit qe mundesojne kryerjen e procesit te votimit ne kohe reale.

Cdo aksion i zakonshem perfaqeson nje vote ne procesin e votimit.

## NENI 14

## KESHILLI MBIKEQYRES

Perberja dhe emerimi i anetareve te keshillit mbikeqyres

Keshilli mbikeqyres perbehet nga te pakten 3 anetare, apo nje numer me i madh te cilet jane persona fizik dhe numri i anetareve te keshillit nuk mund te kaloje asnjehere 21 persona. Shumica e anetareve te keshillit perbehet nga persona te pavarur qe nuk kryejne funksione administrimi.

Anetaret e keshillit mbikeqyres zgjidhen nga mbledhja e asamblese se pergjithshme me shumicen e votave te aksionereve qe marrin pjese ne mbledhje, per nje periudhe prej 3 vjetesh, me mundesi ri-zgjedhje.

Keshilli Mbikeqyres ka keto kompetenca.

1. Dhënia e direktivave për drejtorët menaxhues në lidhje me vënien në zbatim të politikave tregtare;
2. Monitorimi dhe mbikëqyrja e vënies në zbatim të politikave tregtare nga administratoret;
3. Me kërkesë të asamblesë së përgjithshme, përgatitja e masave të cilat bien në kompetencën e këssaj të fundit, rekomandimi i vendimeve për miratim nga asambleja e përgjithshme dhe vënia në zbatim e vendimeve të kësaj të fundit;
4. Thirrja e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme nëse është i nevojshëm për interesat e shoqërisë tregtare;
5. Kujdesi që shoqëria tregtare respekton ligjin në fuqi dhe standardet e kontabilitetit;
6. Shqyrtimi i librave, dokumenteve dhe aktiveve të shoqërisë tregtare;
7. Kujdesi që pasqyrat financiare vjetore përgatiten nga administratoret si edhe raporti i tyre në lidhje me gjendjen dhe rezultatet e shoqërisë tregtare dhe të gjitha shpjegimet dhe informacionet e tjera që kërkon ligji ose statuti; këto dokumente duhet të miratohen dhe të nënshkruhen nga të gjithë anetaret e keshillit për t'iu paraqitur asamblesë së përgjithshme së bashku me një raport të keshillit për arsyet e miratimit dhe një përshkrim se si është monitoruar menaxhimi gjatë gjithë vitit të punës;
8. Kujdesi që bëhet auditimi i librave dhe i regjistrave të paktën një herë në vit nga një auditues i pavarur, së bashku me raportin e audituesit për asamblenë e përgjithshme të aksionarëve, që u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të keshillit mbikeqyres dhe administratoreve. Raporti i keshillit i përmendur në pikën 7 përmban edhe mendimin për raportin e audituesit;
9. Emerimi dhe shkarkimi i administratoreve dhe ndarja e kompetencave te tyre;
10. Përcaktimi i përfitimeve për administratoret;
11. Te miratoje marrjen persiper te detyrimeve me vlere me te larte se 5% te aseteve te shoqerise qe rezulton nga pasqyrat e fundit financiare nepermjet nenshkrimit te huave ose emetimit të obligacioneve ose instrumenteve të tjera të borxhit;
12. Vendosja e bashkëpunimeve tregtare afatgjata dhe propozimi i politikave në lidhje me themelimin e shoqërive tregtare ose grupeve të reja;

**NENI 15**

**EMERIMI I ANETAREVE TE KESHILLIT MBIKEQYRES**

Ne baze te ligjit nr.9901,dated 14.04.2008, si dhe ndryshimet e tjera, per periudhen prej 3 vjetesh, anetaret e keshillit mbikeqyres jane si me poshte:

**Z. Aristeidis Chatzistefanou**, shtetas Grek, lindur me 1963, banues ne Selanik, I identifikuar me leternjoftimin nr. P 151854/98, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

**Z. Janis Mihailidhis**, shtetas Grek, lindur me 1976, banues ne Selanik, I identifikuar me leternjoftimin nr. P 793716/91, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

**Znj. Synthia Michailidou**, shtetase Greke, lindur me 17.12.1977 ne New York, banuese ne Selanik, e identifikuar me pashaporten nr. AB 9474162, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

**Z. Panagiotis Tachtalidis**, shtetas Grek, lindur me 25.03.1960 ne Kilkis, banues ne Selanik, I identifikuar me pashaporten nr. AB 4349679, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

**Z. Aleksander Stillo**, shtetas Shqipetar, lindur me 28.02.1942 neSarande, banues ne Tirane, I identifikuar me pashaporten nr. Z 0787140, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

**Znj. Vojsava Bozgo**, shtetase Shqipetare, lindur me 18.07.1954 ne Durres, banuese ne Durres, e identifikuar me pashaporten nr. Z 0893670, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

**Z. Marjana Lubonja**, shtetase Shqipetare, lindur me 1954 ne Korce, banuese ne Korce, e identifikuar me leternjoftimin nr. AZ 228379, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

**Z. Teuta Rexhepi**, shtetase Shqipetare, lindur me 1964 ne Korce, banuese ne Korce, e identifikuar me pashaporten nr. Z 1612005, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

**Z. Ksanthipi Despotllari**, shtetase Shqipetare, lindur me 1961 ne Korce, banuese ne Korce, e identifikuar me pashaporten nr. Z 1312733, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

## NENI 16
## ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Aktiviteti i shoqerise do te drejtohet nga administratori i cili emerohet nga keshilli mbikeqyres per nje periudhe prej 3 vjetesh me mundesi rizgjedhje. Ne baze te ligjit, administratori do ti nenshtrohet kontrollit te keshillit mbikeqyres. Keshilli mbikeqyres mund te percaktoje edhe shperblimin e administratorit ne momentin e emerimit te tij.

Administratori i nje shoqerie meme nuk mund te zgjidhet si administrator i deges dhe anasjelltas. Administratori i nje shoqerie meme nuk mund te jete kryetari i keshillit mbikeqyres se deges, dhe administratori i nje dege nuk mund te jete kryetari i keshillit mbikeqyres i shoqerise meme. Cdo emerim ne kundershtim me keto parashikime do te jete i pavlefshem.

Administratori ka keto kompetenca:

1. Menaxhon aktivitetin tregtar të shoqërisë tregtare përmes vënies në zbatim të politikave të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
2. Përfaqëson shoqërinë tregtare;
3. Kujdeset për mbajtjen e dokumenteve dhe librave kontabël të nevojshëm;
4. Siguron dhe nënshkruan bilancin vjetor dhe shumat e konsoliduara dhe raportin e punës dhe ia paraqet atë asamblesë së përgjithshme për miratim së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve;
5. Vendos një sistem të paralajmërimit të hershëm në lidhje me zhvillimet që rrezikojne ekzistencën e shoqërisë;
6. Dorëzon informacionet e shoqërisë tregtare për regjistrim Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, nëse nuk parashikohet ndryshe me ligj;
7. Jep llogari përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me vënien në zbatim të politikave tregtare dhe me realizimin e transaksioneve me rëndësi të veçantë për rezultatin e shoqërisë tregtare;

Funksionet e percaktuara nga ligji per anetaret e keshillit mbikeqyres nuk mund te delegohen tek administratori.

- Administrator i shoqerise eshte **Z. Georgios Sougkaris**, shtetas Grek, lindur me 02.10.1973 ne Trikala, banues ne Trikala, I identifikuar me numrin e pashaportes AA 3646033, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

**NENI 17**

**PASQYRAT FINANCIARE**

Administratori duhet te mbaje ne rregull te gjithe llogarite dhe te pergatise raporte financiare te cilat reflektojne kushtet financiare te shoqerise ne perputhje me parimet financiare. Te gjitha aktet e siperpermendura duhet te jene te pergatituara dhe te detajuara ne formen e kerkuar nga ligji.

**NENI 18**

**KONTROLLI I SHOQERISE**

Asambleja e pergjithshme, duhet te emeroje si auditore te pavarur te pakten 2 eksperte kontabel publike te pajisur me licensen perkatese te cilet do te kene pergjegjesite e meposhtme :

(a) Te kontrollojne llogarite e shoqerise dhe te regjistrojne te gjitha veprimet dhe transaksionet tregtare.

(b) Te vertetojne ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, raportin vjetor te shoqerise si dhe deklaratat financiare te saj (bilancin, raportin mbi te ardhurat dhe humbjet e realizuara) si dhe te japin opinionin e tyre nese deklaratat financiare reflektojne realisht gjendjen financiare te shoqerise.

(c) Te informojne administratoret, keshillin Mbikeqyres si dhe Asamblene e Pergjithshme per cdo parregullsi, deficit te vezhguar ne veprimet, transaksionet, procedurat, regjistrimet, apo llogarite e shoqerise te cilat mund te sjellin si pasoje deme te konsiderueshme per shoqerine.

Eksperti Kontabel i shoqerise do te jete **Z. Dhimitraq Pano,** lindur me 23.09.1951, ne Korce, banues ne Korce, me pashaporte nr. Z 1196556 I pajisur me licensen profesionale nr. 105, date 20.01.2001.

## NENI 19
## REGJISTRIMI I AKSIONEVE

Shoqeria ruan ne nje regjister te vecante te gjitha detajet dhe te dhenat e aksionereve, si psh: emri, mbiemeri, apo emri i regjistruar nese eshte person juridik, vleren nominale te aksioneve, adresat e banimit apo selive si dhe daten e regjistrimit.
Personat e Regjistruar ne perptuthje me piken 1 te ketij neni, konsiderohen si aksioneret e shoqerise me te drejta te plota ndaj shoqerise ai dhe ndaj personave te trete.

Administratoret jane pergjegjes per mirembajtjen e regjistrit te aksioneve te shoqerise dhe jane te detyruar te lejojne aksesin ne kete regjister per cdo aksioner apo cdo person tjeter qe kerkon informacion.

## NENI 20

## TRANSFERIMI I AKSIONEVE

Aksionet mund te transferohen nepemjet nje kontrate midis shitesit dhe bleresit. Bleresi konsiderohet si aksioner qe nga momenti i regjistrimit te transaksionit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

## NENI 21

## E drejta e parablerjes

Ne rast te transferimit te aksioneve nga njeri aksioner drejt personave te trete, oferta do tu paraqitet me pare aksionereve te tjere. Aksioneret e tjere mund te ushtrojne te drejten e tyre te parablerjes ne raport me pjesemarrjen e tyre ne kapitalin aksioner, 60 dite nga vendimi i Asamblese per mos pranimin e ofertes. Nese njeri nga aksioneret do te refuzoje te bleje numrin e tij te ofruar te aksioneve,aksioneri transferues do tia komunikoje kete refuzim edhe aksionereve te tjere. Aksioneret e tjere mund te ushtrojne te drejten e tyre te parablerjes 7 dite nga njoftimi per refuzimin e blerjes se aksioneve. Per qellimet e ketij neni, te gjitha njoftimet do te behen nepermjet postes se shkruar, faksit, apo postes elektronike.

Parashikimet e permendura ne kete nen nuk do te aplikohen per shitje apo transferime te kryera nga nje aksioner ne favor te nje aksioneri. Megjithate, ne raste te tilla, transferimi duhet paraprakisht te komunikohet, ne forme shkresore tek aksioneret e tjere.

## NENI 22

## DISPOZITA TE PERGJITHSHME

## DIVIDENTET

Cdo aksioner do te kete te drejten qe perkundrejt aksioneve qe zoteron ne shoqeri te marre pjese ne fitimet realizuara ne masen e percaktuar nga asambleja e pergjithshme.
Fitimet do te perllogariten ne perptuthje me parimet legjislacionit financiar ne fuqi.

Mbledhja e asamblese se pergjthshme mund te vendose qe te mos shperndaje perfitime per nje ose disa nga aksioneret qe zoterojne nje lloj te caktuar aksionesh, me qellim qe te perdoren per interesa te tjere te shoqerise.

**NENI 23**

**NDRYSHIMET**

- Ky dokument mund te ndryshohet ose nje statut i ri mund te pershtatet nepermjet vendimit te Asamblese se Pergjithshme, me ane te shumices se percaktuar ne njoftimin per mbledhjen e Asamblese .

**NENI 24**

**PRISHJA E SHOQERISE**

Shoqeria mund te prishet apo perthithet nepermjet vendimit te Asamblese se Pergjithshme me pranine e aksionereve qe perfaqesojne ¾ te kapitalit te shoqerise.

Shoqëria anonime prishet :

- Kur mbaron periudha kohore për të cilën është themeluar;
- Me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- Me hapjen e një procedure falimentimi;
- Nëse nuk janë kryer aktivitete tregtare për dy vjet;
- Me vendim të gjykatës;
- Për arsye të tjera.

Ne rastin e prishjes se shoqerise, Administratori deklaron dhe depoziton aktet perkatese per prishjen e shoqerise prane QKR. Ne rast te prishjes ne baze te nje vendimi gjyqesor, gjykata regjistron prishjen *ex officio*.

Ulja e numrit të aksionarëve në një të tillë nuk çon në shpërbërjen e shoqërisë.

**NENI 25**

**Shqyrtimi i Mosmarrveshjeve**

Cdo mosmarrveshje apo konflikt do te zgjidhet nepermjet Arbitrazhit te dhomes kombetare te Parisit, dhe ne perputhje me legjislacionin Zvicerian.

Mosmarrveshjet qe lidhen me mardheniet e punes do te zgjidhen nga Gjykata kompetente Shqiptare.

**NENI 26**

**Dispozita perfundimtare**

Te gjitha ceshtjet qe nuk jane parashikuar shprehimisht ne kete statut do te rregullohen ne dispozitat ligjore te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per Shoqerite Tregetare" si dhe ndryshimet qe mund ti ndodhin ketij ligji.

**Ky statut u perpilua ne 4 (kater) kopje origjinale, ne gjuhen Shqipe, ne prani te perkthyesit te gjuhes angleze Z. Elis Bushati.**

**AKSIONERET E SHOQERISE**

**"LEAF TOBACCO A. MICHAILIDES" SA**

**Perfaqesuar nga Z. Georgios Sougkaris**

George Sougkaris

**Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes**

**Perfaqesuar nga Znj. Vojsava Bozgo**

Vojsava Bozgo

Përktheu: ELIS BUSHATI